



Ne baze te nenit 12, paragrafi 1 dhe 2, shkronja (d) nenit 14 dhe 17, shkronja (c) dhe nenit 58 shkronja (h) të Ligjit Nr-03/L-040, për vetëqeverisjen lokale, publikuar në “Gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës, Nr-28/2008”, e në mbështetje të nenit 15, 29, pika 2 te Statutit te Komunës se Suharekës, 01-Nr-8336, i datës 04.11.2008 dhe sipas Njoftimit Nr.2960 të datës 28.07.2022 të lëshuar nga Agjencioni Kosovar i Privatizimit në Prishtinë, Kuvendi i Komunës në Suharekë në mbledhjen e mbajtur me datën 27.09.2022, miratoi këtë:

V E N D I M

Për shpalljen e interesit të përgjithshëm publik

Neni 1

Me këtë vendim shpallen interes i përgjithshëm publikë objektet e cekura më poshtë:

1.1 Objekti me sipërfaqe të përgjithshem **134m²** i cili menaxhohet nga Agjencioni Kosovar i Privatizimit (AKP) e që është i ndërtuar në parcelën kadastrale me **P-72116022-00025-0** me sipërfaqe të përgjithshme 1706m², sipas certifikatës së pronës Nr.3524/2022 e datës 08.09.2022, zona kadastrale Kastërc, vendi i quajtur “Fshat” e evidentuar në emër Komuna e Suharekës. Qëllimi i shpalljes së interesit të përgjithshëm publik është shfrytëzimi i objektit për **“Ndërtimin e shtëpis së kulturës për të rinjtë”** për fshatin Kastërcë.

1.2 Objekti me sipërfaqe të përgjithshem **186m²** i cili menaxhohet nga Agjencioni Kosovar i Privatizimit (AKP) e që është i ndërtuar në parcelën kadastrale me **P-72116045-02269-3** me sipërfaqe të përgjithshme 292m², sipas certifikatës së pronës Nr.3527/2022 e datës 08.09.2022, zona kadastrale Studenqan, vendi i quajtur “Rashica” e evidentuar në emër P.SH shkolla fillore “19. Nëndori” Studenqan. Qëllimi i shpalljes së interesit të përgjithshëm publik është **“Ndërtimi i parkut dhe lojrave për fëmijët”** e fshatit Studenqan.

1.3 Objekti me sipërfaqe të përgjithshem **35m²** i cili menaxhohet nga Agjencioni Kosovar i Privatizimit (AKP) e që është i ndërtuar në pjesën e parcelës kadastrale me **P-72116003-03143-0** me sipërfaqe të përgjithshme 6413m², sipas certifikatës së pronës Nr.3526/2022 e datës 08.09.2022, zona kadastrale Bllacë, vendi i quajtur “Fshat” e evidentuar në emër P.SH shkolla fillore “Emin Duraku” Bllacë dhe në pjesën e parcelës kadastrale me **P-72116003-04514-0** me sipërfaqe të përgjithshme 6532m², sipas certifikatës së pronës Nr.3526/2022 e datës 08.09.2022, zona kadastrale Bllacë, vendi i quajtur “Fshat” e evidentuar në emër pasuri shoqërore “Rrugët e pakategorizuar”. Qëllimi i shpalljes së interesit të përgjithshëm publik është **“Zgjerimi i oborrit të shkollës”** të fshatit Bllacë.

1.4 Objekti me sipërfaqe të përgjithshem **505m²** i cili menaxhohet nga Agjencioni Kosovar i Privatizimit (AKP) e që është i ndërtuar në pjesën e parcelës kadastrale me **P-72116020-00381-1** me sipërfaqe të përgjithshme 8271m², sipas certifikatës së pronës Nr.3529/2022 e datës 08.09.2022, zona kadastrale Gjinoc, vendi i quajtur “Topliçane te Xhade” e evidentuar në emër të Komuna e Suharekës, në pjesën e parcelës kadastrale me **P-72116020-00381-3** me sipërfaqe të përgjithshme 600m², sipas certifikatës së pronës Nr.3529/2022 e datës 08.09.2022, zona kadastrale Gjinoc, vendi i quajtur “Topliçane te Xhade” e evidentuar në emër të Komuna e Suharekës, në pjesën e parcelës kadastrale me



P-72116020-00381-4 me sipërfaqe të përgjithshme 5142m², sipas certifikatës së pronës Nr.3529/2022 e datës 08.09.2022, zona kadastrale Gjinoc, vendi i quajtur “Topliçane te Xhade” e evidentuar në emër të Komuna e Suharekës dhe në pjesën e parcelës kadastrale me **P-72116020-00395-1** me sipërfaqe të përgjithshme 27590m², sipas certifikatës së pronës Nr.3529/2022 e datës 08.09.2022, zona kadastrale Gjinoc, vendi i quajtur “Topliçane” e evidentuar në emër të Komuna e Suharekës. Qëllimi i shpalljes së interesit të përgjithshëm publik është **“Ndërtimi i fushave sportive dhe rekreative”** për fshatin Gjinoc dhe Topliqanë.

1.5 Objekti me sipërfaqe të përgjithshme **463m²** i cili menaxhohet nga Agjencioni Kosovar i Privatizimit (AKP) e që është i ndërtuar në parcelën kadastrale me **P-72116019-01153-1** me sipërfaqe të përgjithshme 21432m², sipas certifikatës së pronës Nr.3530/2022 e datës 08.09.2022, zona kadastrale Duhël, vendi i quajtur “Livadhi Dobiqit/Garulje” e evidentuar në emër të Komuna e Suharekës. Qëllimi i shpalljes së interesit të përgjithshëm publik është **“Ndërtimi i Qendres së Mjekësis Familjare”** për fshatin Duhël me rrethinë.

Neni 2

Autorizohet Kryetari i Komunës që komform dispozitave ligjore në fuqi të ndërmerr të gjitha veprimet të nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.

Neni 3

Bartës për rregullimin e dokumentacionit teknik dhe regjistrimin e pronës në librin kadastral, do të jetë Drejtoria për shërbime pronësore juridike dhe kadaster në Komunën e Suharekës.

Neni 4

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës në bashkëpunim me Drejtoria për shërbime pronësore juridike dhe kadaster në Komunën e Suharkës.

Neni 5

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 15, ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit Nr. 03/L-040 për vetëqeverisjen lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008” dhe nenit 8, lidhur me nenin 9, të Rregullores, Nr. 10/2019, për procedurat e hartimit dhe publikimin e akteve të Komunave, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 të datës 23.10.2021 dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose web-faqen zyrtare të Komunës.

KUVENDI KOMUNËS NË SUHAREKË

01-Nr- 016-62360
Me datë 27.09.2022



Kryesuesi Kuvendit

Mirrec Bexhet KUÇI